



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Raport Konsultativ

Shqyrtimi i njëmbëdhjetë i Tarifave të Energjisë Elektrike

SHTË 11 (2017-2018)

Llogaritja e të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) të OSSH (Viti Relevant 5)

DEKLARATË

Ky Raport Konsultativ është përgatitur nga ZRRE me qëllim të informimit të palëve të interesit. Raporti nuk paraqet Vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të konsiderohet si i tillë.

Shkurt 2017



Përmbajtja

1	Përmbledhje.....	2
2	Hyrje	3
3	Përshtatja e të Hyrave të Lejuara Maksimale	5
4	Bilanci i Energjisë Elektrike.....	5
4.1	Vlerësimi i Bilancit të Energjisë Elektrike të Realizuar dhe të Parashikuar	5
4.2	Humbjet e lejuara në rrjetin e shpërndarjes.....	6
5	Propozimi për të Hyrat e Lejuara Maksimale të OSSH-së	7
5.1	Kostot e Lejuara të Operimit dhe Mirëmbajtjes (OPMct)	7
5.2	Zhvlerësimi i Lejuar (DEPct)	8
5.3	Kthimi i Lejuar në Kapital (RTNct).....	9
5.4	Kostoja e Lejuar e Humbjeve (LSSct)	9
5.5	Faktori i Përshtatjes së të Hyrave (KREvt)	11
5.6	Totali i MAR i OSSH (KEDS).....	12



1 Përmbledhje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aktualisht është duke kryer Përshtatjen e Rregullt dhe procesin e Azhurnimit Vjetor për të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) që do të mbulohen nga Kompanitë e Rregulluara. Në këtë proces, ZRRE-ja do të aprovojë MAR të azhurnuar për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT, KOSTT), Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH, KEDS) dhe Furnizuesin me Shërbime Universale të Energjisë Elektrike (FSHU), bazuar në propozimet e dorëzuara nga Kompanitë e Rregulluara. Këto më pas do të përdoren nga Kompanitë e Rregulluara për të propozuar tarifat e tyre për këtë vit që do të jenë efektive nga data 1 prill 2017.

Vlerat bazë për komponentët e MAR janë përcaktuar në Shqyrtimin Periodik të bërë në vitin 2012 dhe mbesin të vlefshme për një periudhë shumëvjeçare. Shqyrtimi aktual ka të bëjë me vlerësimin e propozimeve për MAR të paraqitura nga Kompanitë e Rregulluara dhe përshtatjen e tyre me vlerat bazë. Ky shqyrtim vlerëson nëse propozimet e të licencuarve janë llogaritur saktë në përputhje me kërkesat ligjore.

Në korrik të vitit 2016, Parlamenti i Republikës së Kosovës, ka miratuar Ligjet e reja për sektorin e energjisë, të cilat kanë sjellë ndryshime esenciale në rregullimin e sektorit. Ky është viti i parë që ZRRE ndërmerr një Shqyrtim Tarifor me ligjet e reja në fuqi për sektorin e energjisë në Kosovë dhe rrethanat e reja të krijuara me ndryshimet ligjore, do të jenë mjaft sfiduese për ZRRE-në dhe të gjithë akterët. Prandaj ZRRE fton kompanitë e rregulluara, konsumatorët dhe të gjitha palët tjera të interesit, që të japin kontributin e tyre në këtë proces, duke shqyrtuar dhe komentuar të dhënat dhe pikëpamjet e paraqitura në këtë Raport Konsulativ, në mënyrë që vlerësimi të jetë i saktë për të Hyrat e Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes.

Palët të cilat dëshirojnë të shprehin mendimet rreth qëndrimit të ZRRE-së ftohen që të dorëzojnë komentet e tyre me shkrim në postën elektronike ero.pricing-tariffs@ero-ks.org jo më vonë se **14 mars 2017**. Gjithashtu, komentet mund të dërgohen me postë në:

Zyra e Rregullatorit për Energji
Departamenti për Tarifa dhe Çmime
Rr. Dervish Rozhaja Nr. 12, Prishtinë, 10000, Kosovë

Dokumentet Relevante

Vlerësimi fillestar i ZRRE-së për formularët e raportimit të OSSH-së të dorëzuara në kuadër të procesit të Shqyrtimit Periodik	http://ero-ks.org/Price%20and%20Tariffs/2012/albanian/Vleresimi_fillestar_KEK_shqip.pdf
Vlerësimi i përkohshëm i ZRRE-së të MAR të OSSH në kuadër të procesit të Shqyrtimit Periodik – Vlerësim i detajuar	http://ero-ks.org/Tarifat/2012/Vleresim_i_perkoshem_OSSH_FP_EE.pdf
Vlerësimi përfundimtar i MAR të OSSH në kuadër të procesit të Shqyrtimit Periodik – Vlerësim i detajuar	http://ero-ks.org/Tarifat/2013/Proceset%20e%20Shqyrtimit/Vleresimi_perfundimtar_per_OSSH_FPEE_22Mars2013.pdf



2 Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është institucioni i pavarur i cili përcakton kontrollet e çmimit për kompani të rregulluara të cilat operojnë në tregun e rregulluar të energjisë elektrike në Kosovë. Pas ndryshimeve ligjore në sektorin e energjisë, ZRRE do të përcaktojë kontroll të çmimit vetëm për ato segmente të energjisë të cilat konsiderohen monopole natyrore (rrjetet e Transmetimit dhe Shpërndarjes, si dhe Furnizimin me Shërbimin Universal).

ZRRE ka nxjerr Udhëzuesin për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë në muajin janar 2017. Ky Udhëzues përcakton mënyrën, kushtet dhe kohën e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike në Kosovë, në nivelin e prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike. Blerjet e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në transmetim dhe shpërndarje deri tani janë kryer nga KESCO për OST dhe OSSH, kurse tani operatorët duhet të sigurojnë energjinë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjet nga tregu i energjisë elektrike nën kushtet e konkurrencës.

Rregullimi i Çmimit është mjet që përdoret nga ZRRE në mënyrë që të përcaktohen Të Hyrat e Lejuara Maksimale – MAR, të cilat Kompanitë e Rregulluara do ti mbledhin për ofrimin e shërbimeve të rregulluara. MAR caktohet gjatë Shqyrtimeve Periodike duke analizuar hollësisht shpenzimet dhe investimet të cilat Kompanitë planifikojnë t'i bëjnë përgjatë kohës së kontrollit të çmimit. MAR caktohet në nivelin që mundëson të licencuarit e rregulluar t'i mbulojnë kostot e arsyeshme operative dhe të mirëmbajtjes së aseteve të tyre dhe të realizojnë kthim të arsyeshëm në investimet e tyre. Gjithashtu, ZRRE përcakton caqe të efikasitetit, të cilat synojnë ngritjen e efikasitetit operativ të kompanive dhe të ofrojnë stimulime për arritjen e caqeve apo ndëshkime nëse kompanitë dështojnë t'i arrijnë ato.

Shqyrtimi Periodik është bërë nga ZRRE në vitin 2012 (SHTE7) dhe ka caktuar MAR-in e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) për një periudhë pesë vjeçare deri në vitin 2017. Shpenzimet kapitale të lejuara për projektet kyçe dhe caqet e efikasitetit të përcaktuara nga ZRRE-ja gjatë shqyrtimit periodik SHTE7 janë të përmbledhura në Tabela 1 më poshtë.

Tabela 1 SHTE 7 MAR i OSSH (KEDS)

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (KEDS)	
Investimet e parashikuara (2013-2017)	107.25 milion € përgjatë periudhës rregullative
Projektet kyçe	Përforcimi i rrjetit (zëvendësimi i linjave 10 kV dhe 0.4 kV); eliminimi i bllokadave, veçanërisht në mbingarkesat e 35 kV dhe 10 kV, Eliminimi i linjave të cilat rrinin varur, që konsideroheshin si një rrezik për publikun



Faktorët e efikasitetit

16.5% (pikë përqindje) të zvogëlimit të humbjeve përgjatë 6 viteve – gati përgjysmim i humbjeve deri në fund të periudhës rregullative. Faktori i efikasitetit prej 5% i aplikuar për tri vite relevante tarifore.



3 Përshtatja e të Hyrave të Lejuara Maksimale

ZRRE, bazuar në Rregullën për Vendosijen të Hyrave të Lejuara Maksimale për OSSH, ka pranuar aplikacionet dhe ka analizuar me kujdes të gjithë komponentët e kostove dhe kërkesat e të licencuarit. Gjatë procesit të Përshtatjes së Rregullt, ZRRE përdor rezultatet e marra gjatë procesit të Shqyrtimit Periodik në SHTE7 dhe përshtat MAR për të reflektuar ndryshimet në mes të kostove që kanë qenë të parashikuara gjatë Shqyrtimit Periodik dhe kostove aktuale të shkaktuara nga Kompanitë e Rregulluara për shkak të arsyeve që janë jashtë kontrollit të tyre. Gjatë këtij procesi ZRRE do të:

1. Indeksojë Kostot Operative dhe të Mirëmbajtjes për Faktorin e Efikasitetit i cili caktohet gjatë procesit të Shqyrtimit Periodik dhe për Inflacionin Vjetor i cili caktohet duke përdorur Indekset e Harmonizuara të Çmimeve të Konsumit (HICP) për vendet e Eurozonës;
2. Caktojë Kostot e Lejuara të Humbjeve (LSSCt) për OSSH, dhe t'i azhurnojë këto në mënyrë që të përfshijnë ndryshimin në mes të kostove të lejuara dhe të realizuara të humbjeve për Periudhën paraprake Rregullative, të cilat mund të kenë ndodhur si rezultat i ndryshimeve në kostot e blerjes së energjisë me shumicë apo i ndryshimeve në rrjedhat e energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes;
3. Azhurnojë MAR-in e OSSH-së në mënyrë që të reflektojë ndryshimin në mes të të Hyrave të Lejuara dhe të Realizuara në Vitin paraprak Relevant (t-1), duke përfshirë edhe të hyrat e përjashtuara;
4. Caktojë MAR-in e OSSH-së për Vitin Relevant t.

4 Bilanci i Energjisë Elektrike

Vitet e kaluara ZRRE-ja ka përdorur parashikimin e bilancit të energjisë të aprovuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) për Vitin Relevant t për të llogaritur MAR të KEDS-it.

Duke filluar nga ky vit relevant tarifor, ZRRE do të përdorë bilancin e aprovuar nga Bordi i ZRRE-së, me qëllim të kalkulimit të të Hyrave të Lejuara të OSSH-së, ndërsa për përshtatjet e vitit paraprak do të përdoret bilanci i realizuar.

Bilanci i aprovuar nga ZRRE gjithashtu do të përdoret për të llogaritur blerjet e energjisë me shumicë për mbulimin e humbjeve të transmetimit, shpërndarjes dhe tarifën me pakicë për Shërbimin Universal.

4.1 Vlerësimi i Bilancit të Energjisë Elektrike të Realizuar dhe të Parashikuar

Me qëllim të vlerësimit të kostove që kanë të bëjnë me blerjen e humbjeve në nivel të OSSH-së, ZRRE ka analizuar të dhënat e raportuara nga KEDS për vitin 2016 dhe të dhënat për parashikimin e bilancit për vitin 2017.

Pas vlerësimit të të dhënave për vitin 2016, ZRRE ka vërejtur se ka disa dallime në sasinë e energjisë së faturuar nga KEDS me ato të vlerësuara nga ZRRE në sasinë prej 145 GWh, i cili është reflektuar



gjatë vlerësimit të të Hyrave të OSSH. Niveli i dallimit të paraqitur në aplikacionin e KEDS ishte 82.5 GWh, e raportuar si energji për rikthimin e humbjeve.

Sa i përket bilancit të parashikuar për vitin 2017, ZRRE ka marrë parasysh nivelin e planifikuar të sasisë së energjisë për faturim në rrjetin e shpërndarjes dhe më pastaj ka aplikuar cakun e humbjeve për të kalkuluar energjinë e nevojshme për OSSH-në.

Analiza e bilancit të realizuar për vitin 2016 dhe atij të parashikuar për vitin 2017 është paraqitur në tabelën në vijim:

Bilanci i energjisë elektrike ne OSSH	Njësia	SHTE 10 Realizimi	SHTE 11 Propozimi
Hyrja ne OSSh	GWh	4,806.8	4,208.1
Energjia e pafaturuar në Veri	GWh	251.9	246.0
Hyrja në OSSh pa energjinë e pa faturuar	GWh	4,554.9	3,962.1
Hyrja në OSSh pa energjinë e pa faturuar	%	5.2%	5.8%
Humbjet teknike dhe komerciale në OSSh	GWh	1,175.4	718.4
	%	24.4%	18.1%
Gjithësej humbjet	GWh	1,427.4	964.4
	%	29.7%	24.0%
Energjia e mbetur për faturim	GWh	3,379.4	3,243.7
Faturimi nga KEDS	GWh	3,235.0	3,243.7
Korrigjimi në faturim	GWh	144.4	

Implementimi i ndryshimeve ligjore në kuadër të liberalizimit të tregut ka një ndikim esencial në trajtimin e humbjeve në sistemin e energjisë elektrike, ku përfshihen edhe humbjet e veriut. Duke filluar nga viti i ardhshëm tarifar 2017/2018, trajtimi i humbjeve të veriut do të bartet në nivel të Transmetimit, me qëllim të pjesëmarrjes së të gjithë konsumatorëve në mbulimin e tyre, derisa këto humbje janë jashtë kontrollit të të licencuarve do të trajtohen si të tilla derisa të hiqen barrierat politike, me ç'rast edhe do të eliminoreshin nga sistemi energjetik.

4.2 Humbjet e lejuara në rrjetin e shpërndarjes

ZRRE-ja ka përcaktuar caqet shumëvjeçare për nivelin e lejuar të humbjeve (në terma të përqindjes) në rrjetin e shpërndarjes. Këto nivele të lejuara përdoren për të përcaktuar kostot e humbjeve të cilat OSSH do t'i mbulojë nga tarifat e aprovuara. Kjo qasje në lidhje me zvogëlimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, ka për qëllim përmirësimin e shërbimit në rrjet duke nxitur OSSH-në që të kursej nga kostot se tij në rast të arritjes së caktit, ndërsa do të ndëshkohet për pjesën të cilën e tejkalon nivelin e lejuar të humbjeve.



Nivelet e lejuara të humbjeve në shpërndarje fillimisht janë caktuar në SHTE6 duke u zvogëluar nga 3% (pikë përqindje) përgjatë tri viteve të para dhe nga 2.5% (pikë përqindje) në tri vitet e fundit, si rezultat i përmirësimeve të vazhdueshme të pritshme në rrjet me qëllim të zvogëlimit të humbjeve teknike dhe përpjekjet e rritura për të zvogëluar vjedhjet e energjisë elektrike¹.

Niveli i lejuar i humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2017 është 18.1%, nga 20.6% sa ishte i lejuar për vitin 2016.

5 Propozimi për të Hyrat e Lejuara Maksimale të OSSH-së

Me qëllim të vlerësimit të të Hyrave të Lejuara Maksimale për OSSH, ZRRE ka analizuar me kujdes secilin element të kostos.

MAR llogaritet çdo vit sipas formulës në vijim:

$$MAR_t = OPMC_t + DEPC_t + RTNC_t + LSSC_t + LICC_t + KREV_t$$

Ku

MAR_t janë të hyrat e lejuara maksimale në vitin relevant t

$OPMC_t$ janë kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes në vitin relevant t

$DEPC_t$ është zhvlerësimi i lejuar në vitin relevant t

$RTNC_t$ është kthimi i lejuar në kapital në vitin relevant t

$LSSC_t$ është kostoja e lejuar e humbjeve në vitin relevant t

$LICC_t$ është kostoja e taksës për licencë në vitin relevant t

$KREV_t$ është faktori i korrigjimit të të hyrave në vitin relevant t

Llogaritja e secilit nga këta komponentë është shtjelluar më poshtë.

5.1 Kostot e Lejuara të Operimit dhe Mirëmbajtjes (OPMCt)

Pas shturjes ligjore dhe funksionale të OSSH-së dhe Furnizuesit në vitin 2015, disa nga aktivitetet e Furnizuesit kanë kaluar tek OSSH e cila ka rezultuar me bartje të disa kostove nga Furnizuesi tek OSSH. Kjo nuk ka pasur ndikim në rritjen e kostove të përgjithësime të cilat do të ndikonin konsumatorët fundorë, por vetëm transfer të kostove brenda sistemit. Për vitin 2017 do të aplikohen përshtatjet e nevojshme për inflacion dhe faktor të efikasitetit duke u bazuar në kostot e lejuara të vitit paraprak (2016), pasi që transferimi i kostove në mes të OSSH dhe Furnizuesit ka përfunduar në shqyrtimin e fundit tarifor 2016 (SHTE10).

Përcaktimi i kostove Operative dhe të Mirëmbajtjes është bërë duke përdorur formulën e mëposhtme:

¹http://ero-ks.org/Vendimet/Shqip/2012/V_399_2012.pdf



$$OPMct = OPMct-1 * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - Et)$$

Ku

OPMct janë kostot e lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes në vitin relevant t

OPMct-1 janë kostot e lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes në vitin relevant t-1

CPI_{t-1} është vlera e realizuar e inflacionit në vitin relevant t-1, e matur duke përdorur "Indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) – të gjitha njësitë në Eurozonë" të publikuara nga Eurostat-i, apo ndonjë vlerësim tjetër i inflacionit që rregullatori e përcakton të jetë si masa më e mirë e ndryshimit në kostot operative dhe të mirëmbajtjes përgjatë kohës dhe që është e lejuar gjatë shqyrtimit periodik

Et është Faktori i Efikasitetit në vitin relevant t, i cili caktohet gjatë shqyrtimeve periodike

ZRRE-ja ka aplikuar faktorin e efikasitetit prej 5% siç është përcaktuar në Shqyrtimin Periodik për vitin 2017. Norma e aplikuar e inflacionit është 0.2% dhe është llogaritur nga Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumatorëve për vendet e Eurozonës për vitin 2016.

Niveli i lejuar i kostove të operimit dhe mirëmbajtjes vitin relevant tarifor 2017 (SHTE 11), pas aplikimit të faktorëve të sipërpërmendur ka rezultuar të jetë 23.8 milion €.

5.2 Zhvlerësimi i Lejuar (DEPCt)

Rregulla për Vendosjen e të Hyrave të Lejuara Maksimale për OSSH supozon se zhvlerësimet e lejuara zbuten dhe profilizohen gjatë Periudhës Rregullative. Pasi që asnjë zbutje nuk është aplikuar në praktikë, ZRRE-ja ka përdorur formulën e përshtatjes si në vijim, e cila është e njëjtë me formulën e miratuar në vitet e mëparshme:

$$DEPC_t = DEPC_{t-1} * (CPI_{t-1}) + DEPC_{ft}$$

Ku

DEPC_t është zhvlerësimi tjetër i lejuar në vitin relevant t

DEPC_{t-1} është zhvlerësimi i lejuar në vitin relevant t-1

CPI_{t-1} është vlera e realizuar e inflacionit në vitin relevant t-1, e matur duke përdorur "Indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) – të gjitha njësitë, për Eurozonën" publikuar nga Eurostat-i

DEPC_{ft} është zhvlerësimi i lejuar i parashikuar në vitin relevant t, i cili përcaktohet në shqyrtimet periodike

Zhvlerësimi i lejuar për vitin relevant tarifor 2017 (SHTE 11), është caktuar të jetë 9.4 milion €.



5.3 Kthimi i Lejuar në Kapital (RTNCt)

Ashtu si në llogaritjen e komponentëve të DEPct, ZRRE-ja nuk ka profilizuar ose zbutur kthimin e lejuar në kapital gjatë Shqyrtimit Periodik. Prandaj, kjo komponentë është llogaritur me formulën e mëposhtme:

$$RTNC_t = RTNC_{t-1} * (CPI_{t-1}) + RTNC_{ft}$$

Ku

$RTNC_t$ është kthimi i lejuar në kapital në vitin relevant t

$RTNC_{t-1}$ është kthimi i lejuar në kapital në vitin relevant t-1

CPI_{t-1} është vlera e realizuar e inflacionit në vitin relevant t-1, e matur duke përdorur "Indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) – të gjitha njësitë, për Eurozonën" publikuar nga Eurostat-i

$RTNC_{ft}$ është kthimi i lejuar në kapital i parashikuar në vitin relevant t, i cili përcaktohet në shqyrtimet periodike

Kthimi i lejuar në kapital për OSSH për vitin relevant tarifor 2017 (SHTE 11), është caktuar të jetë 16 milion €.

5.4 Kostoja e Lejuar e Humbjeve (LSSCt)

Kostoja e Lejuar e Humbjeve për OSSH përcaktohet gjatë secilës Përshtatje të Rregullt përmes formulës së mëposhtme (Shtojca 1 paragrafi 2.4 i Rregullës për Vendosjen e të Hyrave të Lejuara Maksimale për OSSH):

$$LSSC_t = LSSA_t * REUE_t * WHEA_t + (LSSCa_{t-1} - LSSCf_{t-1}) * (1 + I_t) + (LSSCa_{t-1} - LSAC_{t-1}) * LSSF_t$$

Ku

$LSSC_t$ është kostoja e lejuar e humbjeve për vitin relevant t

$LSSA_t$ janë humbjet e lejuara, që janë paraqitur si përqindje e energjisë që hyn në sistemin e shpërndarjes në vitin relevant t

$REUE_t$ janë njësitë e energjisë (MWh) që hyjnë në sistemin e shpërndarjes në vitin relevant t

$WHEA_t$ është mesatarja e kostos me shumicë të energjisë (€/MWh) në vitin relevant t

$LSSCa_{t-1}$ është kostoja e realizuar e humbjeve të lejuara në vitin relevant t-1, (llogaritur duke përdorur humbjet e lejuara)

$LSSCf_{t-1}$ është kostoja e parashikuar e humbjeve në vitin relevant t-1, (llogaritur duke përdorur humbjet e lejuara)



I_t	<i>është norma e interesit për vitin relevant t, që llogaritet bazuar në EURIBOR plus S%, ku S paraqet vlerën që do përcaktohet nga Rregullatori gjatë shqyrtimeve periodike që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për huatë afatshkurtra mbi normën e EURIBOR-it</i>
$LSAC_{t-1}$	<i>është kostoja e humbjeve të realizuara nga OSSH gjatë blerjes së energjisë si kompensim i energjisë së humbur në rrjetin e shpërndarjes (nuk llogaritet duke përdorur humbjet e lejuara) në vitin relevant t-1</i>
$LSSF_t$	<i>është faktori i ndarjes së humbjeve në vitin relevant t, që caktohet gjatë shqyrtimeve periodike.</i>

Norma e interesit e përdorur për të llogaritur kompensimin në mes të kostove të realizuara dhe të lejuara në vitin paraprak relevant është llogaritur duke përdorur preminë -S të caktuar nga ZRRE-ja gjatë Shqyrtimit Periodik (15.0%) plus normën vjetore të EURIBOR (-0.1%²). Prandaj, norma e interesit për përshtatje është caktuar në 14.9%. Faktori i Ndarjes së Humbjeve në Vitin Relevant t është aplikuar 0%. Caku i lejuar i humbjeve për sistemin e shpërndarjes për SHTE11 është 18.1%. Llogaritja është e përmbledhur në tabelën në vijim.

² Norma Euribor për 10 shkurt 2017 <http://www.euribor-rates.eu/euribor-rate-12-months.asp>



Tabela 2 Llogaritja e Kostove të Lejuara të Humbjeve të OSSH-së

OSSH MAR		SHTE10 E lejuar	SHTE11 E realizuar	SHTE11 E propozuar
Parametrat e indeksimit				
Faktori i efikasitetit	%	5.00%	5.00%	5.00%
Faktori profilizues		0.00	0.00	0.00
HICP	%	0.21%	0.20%	0.20%
Euribor	%	-0.13%	-0.10%	-0.10%
S-factor	%	15.00%	15.00%	15.00%
It	%	14.87%	14.90%	14.90%
Humbjet e lejuara (LSSCt)				
LSSAt	%	20.6%	25.8%	18.1%
REUEt	GWh	4,027.1	4,554.9	3,962.1
WHEAt	€/MWh	34.1	34.1	35.4
LSSCat-1	mil€		32.2	
LSSCft-1	mil€	28.3		
LSAct-1	mil€		40.1	
LSSCt	mil€			29.7

Kostoja e lejuar e humbjeve për KEDS në kuadër të SHTE11 është 29.7 milion €. Gjatë blerjes së këtyre humbjeve OSSH do të paguaj obligimet për OS dhe OT, të cilat janë vlerësuar të jenë 0.7 milion euro dhe janë të paraqitura në tabelën e MAR të propozuar në fund të dokumentit.

5.5 Faktori i Përshtatjes së të Hyrave (KREVt)

Ndryshimi në mes të të Hyrave të Lejuara nga ZRRE-ja për SHTE10 dhe të Hyrave të Realizuara që janë mbledhur nga OSSH gjatë periudhës së njëjtë është llogaritur sipas formulës në vijim:

$$KREV_t = (MAR_{t-1} - ARR_{t-1}) * (1 + I_t)$$

Ku

ARR_{t-1} janë të hyrat e rregulluara të realizuara në vitin relevant t-1

MAR_{t-1} janë të hyrat e lejuara maksimale siç janë të përcaktuar për vitin relevant t-1

It është norma e interesit për vitin relevant t, që llogaritet bazuar në EURIBOR plus S%, ku S paraqet vlerën e përcaktuar nga Rregullatori gjatë shqyrtimeve periodike që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për huatë afatshkurtra mbi normën e EURIBOR-it

Ndryshimi në mes të MAR të lejuar nga ZRRE-ja prej 75.6 milion € dhe të Hyrave të realizuara (ARR) nga OSSH-ja prej 80.8 milion € (përfshirë rikthimin e humbjeve dhe furnizimin e pafaturuar për regjionin e Ferizajt) përshtatet në MAR të vitit 2017, i indeksuar për normën e inflacionit.



5.6 Totali i MAR i OSSH (KEDS)

Si rezultat i kalkulimeve të secilit komponent të kostove, MAR i propozuar për OSSH për vitin 2017 është 67.8 milion €. Llogaritja e kësaj vlere është e treguar më poshtë.

Tabela 3 Propozimi i MAR të OSSH (KEDS)

OSSH MAR		SHTE10 E lejuar	SHTE10 E realizuar	SHTE11 E propozuar
Parametrat e indeksimit				
Faktori I efikasitetit	%	5.00%	5.00%	5.00%
Faktori profilizues		0.00%	0.00%	0.00%
HICP	%	0.21%	0.20%	0.20%
Euribor	%	-0.13%	-0.10%	-0.10%
S-factor	%	15.00%	15.00%	15.00%
It	%	14.87%	14.90%	14.90%
Kosto operative dhe e mirëmbajtjes (OPMct)				
$OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$	€m	25.09		23.81
Zhvelrësimi I lejuar (DEPCt)				
$DEPC_t = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	8.75		9.39
Kthimi I lejuar (RTNCt)				
$RTNC_t = RTNC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	14.22		15.99
Obligimet për OS dhe OT				
Obligimet për OS dhe OT	€m			0.69
Humbjet e lejuara (LSSct)				
LSSAt	%	20.63%	25.77%	18.13%
REUet	GWh	4,027.1	4,554.9	3,962.1
WHEAt	€/MWh	34.1	34.1	35.4
LSSCat-1			32.1	
LSSCft-1		28.3		
LSACT-1			40.1	
LSSCt				29.7
Azhurnimet				
Të hyrat e parregulluara	€m	-5.33		-5.9
KREV				
KREV	€m	4.13		-4.3
OSSH MAR				
	€m	76.5	80.8	67.8